

VENDIM
Nr. 46, datë 2.4.2024

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR
VITIN 2024, PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS-KANALIZIME, TË CILAT
FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 738/4 prot., datë 29.3.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2024, për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 1245 prot., datë 29.2.2024, protokolluar me tonën me nr. 738 prot., datë 4.3.2024, ka paraqitur kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF 6/10/20 kV, ujësjellës-kanalizime, si dhe klientët 35 kV ujësjellës-kanalizime.

- Rezulton se shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve gëzojnë status të veçantë, të përcaktuar në pikën 1, të nenit 8, të VKM-së nr. 456/2022, të ndryshuar, si shoqëri, të cilat sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve.

- Bashkëlidhur aplikimit rezulton gjithashtu dhe shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 457/1 prot., datë 19.2.2024, me lëndë “Për miratimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a.”, në të cilën, ndër të tjera, si pjesë e “Programit Ekonomik Financiar të KESH sh.a., për vitin 2024 dhe parashikimin për vitet 2025–2028” duke përcaktuar ndër të tjera dhe furnizimin me të gjithë sasinë e nevojshme, të klientëve universalë, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike për furnizimin e energjisë në marrëdhënien KESH sh.a.

- Rezulton se çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a., me qëllim mbulimin e kërkesës për furnizimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, për vitin 2024, të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV, si dhe 20/10/6 kV do të jetë 5.70 lekë/kwh.

- Rezulton se në këto çmime shoqëria ka përfshirë edhe zërin “kosto të disbalancave” duke dhënë arsytimin në vijim se: Duke qenë se sipas nenit 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, në çmimin e përlogaritur nuk parashikohen kostot e disbalancave, kërkojmë reflektimin e kësaj kostoje...”.

- Vlerësojmë se aplikimi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 87, pikës 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 7, pikës 1, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201/2017, të ndryshuar, çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja duhet të përfshijë vetëm kostot e identifikuar nga furnizuesi, sipas përcaktimeve të kësaj metodologjie.

- Bazuar në nenin 8, të metodologjisë së sipërcituar, komponentët që merren në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë:

- Kostot administrative, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”, vijnë të jenë 1.06 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh;
- Kthimi për riskun prej 3% (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike të kësaj kategorie klientësh) në vlerën 0.17 lekë/kwh;
- Tarifat e shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuara me vendimin nr. 73, datë 13.4.2022, të cilat janë në fuqi dhe për vitin 2024, me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, të diferencuara sipas nivelit të tensionit në të cilin këta klientë janë të lidhur.
- Në zbatim të metodologjisë, si dhe bazuar në të dhënat e aplikimit të FSHU sh.a., çmimet e shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë përlogaritur nga ERE si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime 2024				
VITI 2024			Nivelet e tensionit	
			35 kV	20/10/6 kV
		Nësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	5.70	5.70
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.17	0.17
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të njetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të njetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Lekë/kWh	9.33	11.77

- Referuar pikës 2, të nenit 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, në çdo rast çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë të klientët që furnizohen në atë nivel tensioni, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014.

- Duke qenë se metodologjia e ka vendosur si parim përcaktimin e pikës 2, të nenit 8, në kohën kur tregu nuk ka qenë i hapur dhe ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin në fuqi, përfshirë dhe VKM-në nr. 456/2022, e cila i jep një status të veçantë shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe kostot e furnizimit nga FSHU sh.a. të ujësjellës-kanalizimeve janë më të ulëta se çmimi i shitjes me pakicë të klientët fundorë, vlerësohet të pezullohet kjo pikë e metodologjisë deri në hartimin e metodologjisë së re. Bazuar në përcaktimet e metodologjisë respektive, elementet e formulës përlogaritëse, si dhe të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë e ujësjellës-kanalizime, për vitin 2024, do të jetë:

- 9.33 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV;
 - 11.77 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV;
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pezullimin e pikës 2, të nenit 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për klientët që gëzojnë një status të veçantë, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.

2. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2024, prej 9.33 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.

3. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2024, prej 11.77 lekë/kwh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

4. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

5. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi